

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 05, datë 26.02.2021

Mbi miratimin e “Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2021-2023”

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “r”, të nenit 7 pika 6 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Komitetit të Strategjisë në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, i ngritur me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 33, datë 12.12.2017, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2021-2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi




Sekretar

Donald Duraj

Kryetar



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE



PLANI STRATEGJIK 2021-2023



Tryeza e lëndës

| | |
|--|----|
| Hyrje | 3 |
| Profili i Agjencisë | 3 |
| Misioni, Vizioni dhe Vlerat | 5 |
| Mjedisi operacional | 6 |
| Plani Strategjik 2021-2023 | 7 |
| Parakushtet e planifikimit strategjik | 7 |
| Prioriteti strategjik 1 | 8 |
| Prioriteti strategjik 2 | 17 |
| Matrica e Planit Strategjik 2021 2023 | 21 |
| Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike | 25 |
| Plani Financiar 2021 - 2023 | 26 |
| Performanca e Planit Strategjik 2018-2020 | 29 |
| Përmbyllje | 39 |



Hyrje

Plani strategjik tre-vjeçar identifikon objektivat strategjike të Agjencisë dhe projektet që lidhen me periudhën e planifikimit 2021 - 2023. Ai është rezultat i punës së strukturave të Agjencisë dhe është hartuar në vijueshmëri të Planit Strategjik 2018-2020, duke përfshirë iniciativa dhe projekte të reja për realizimin e tyre.

Kriza e shëndetit publik dhe ekonomisë, si pasojë e pandemisë Covid-19, na ka nxitur që në këtë Plan Strategjik të fokusohemi më shumë në iniciativa mbi gatishmërinë operacionale dhe partneritetin strategjik, ndërkohë që kemi vazhduar të monitorojmë dhe vlerësojmë rreziqet. Për periudhën e planifikimit, pasiguritë e vazhdueshme na detyrojnë të përqendrohemi në intensifikimin e punës sonë për gatishmëri, në mënyrë që të rrisim aftësitë tona reaguese ndaj situatave me të cilat mund të përballemi.

Profili i Agjencisë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2002 në bazë të ligjit nr. 8873, datë 29 mars 2002, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me ligjin nr. 10106, datë 30 mars 2009 dhe ligjin nr.78/2012, datë 26 korrik 2012. Nga muaji korrik i vitit 2014, aktiviteti i Agjencisë rregullohet nga ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me ligjin nr. 39/2016 dhe ligjin nr. 132/2016. Në përputhje me ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia i raporton Bankës së Shqipërisë (“Autoriteti Mbikëqyrës”), Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Agjencia është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave dhe e Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave. Agjencia është themeluar me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit (“SHKK-të”) që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Anëtarësimi në skemën e sigurimit të




depozitave është i detyrueshëm për të gjitha institucionet që mbledhin depozita dhe licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,500,000 Lek depozituesit në çdo bankë anëtare të skemës së sigurimit. Njëkohësisht, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,000,000 Lek depozituesit anëtarë në çdo shoqëri kursim-krediti anëtare e skemës së sigurimit.

Agjencia ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të ligjit për sigurimin e depozitave. Në veçanti, por jo vetëm, Agjencia anëtarëson dhe përjashton subjektet në skemë; verifikon të dhënat e raportuara periodikisht nga subjektet anëtare; kryen verifikime të plota dhe të pjesshme në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave në subjektet anëtare; zhvillon veprimtari për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për skemën e sigurimit të depozitave; kompenson depozitat, sipas dispozitave të këtij ligji; arkëton kontributet

fillestare, primet e sigurimit, dhe kontributet e jashtëzakonshme; dhe investon mjetet financiare, në përputhje me aktet rregullative.

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar në kuadër të paketës ligjore të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri, me Bankën e Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Agjencisë kryen edhe detyra të tjera shtesë. Në bazë të këtij ligji, Agjencia administron fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fond i cili përbëhet nga kontributet e bankave dhe përdoret sipas dispozitave ligjore në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.



Paraqitje skematike e skemës së sigurimit dhe kompensimit të depozitave



Misioni, Vizioni dhe Vlerat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

MISIONI I AGJENCISË

Përmbushja e objektivave publikë të skemës së sigurimit të depozitave në mbështetje dhe në zbatim të ligjit “Për sigurimin e depozitave”.

VIZIONI I AGJENCISË

Të jemi kontribues dinamik në sistemin e sigurisë financiare në vend duke adresuar në kohë dhe me transparencë çështje që lidhen me efektivitetin e skemës së sigurimit të depozitave.

VLERAT E AGJENCISË

Integriteti – Veprojmë në përputhje me standardet etike dhe profesionale të institucionit.

Puna në Grup – Komunikojmë dhe bashkëpunojmë me efektivitet me njëri-tjetrin duke vlerësuar dhe respektuar vlerat individuale.

Përkushtimi – Punojmë me pasion dhe dedikim për arritjen e objektivave institucionale.

Transparenca – Sigurojmë një qasje të hapur dhe nivel të lartë llogaridhënie të institucionit ndaj depozituesit dhe të gjitha grupeve të interesit.

Përgjegjshmëri – Garantojmë vendimmarrje profesionale dhe besueshmëri në administrimin e skemës së sigurimit të depozitave.







Mjedisi operacional mbi të cilin është hartuar Plani Strategjik





Shënim: Të dhënat i referohen periudhës më 31.12.2020.



12 Banka anëtare të skemës



8 shkk anëtare të skemës





Plani Strategjik 2021-2023

Parakushtet e planifikimit strategjik

Në planifikimin e saj strategjik për periudhën 2021-2023, Agjencia ka marrë në konsideratë si parakusht kryesor ndikimin e mundshëm të pandemisë COVID-19 në skemën e sigurimit të depozitave. Në bashkëpunim me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare do të vazhdojmë të monitorojmë situatat e mundshme ndaj të cilave mund të ekspozohen anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave. Agjencia konsideron që situata e pandemisë së Covid-19 nuk do të përkeqësohet si pasojë e procesit të vaksinimit, dhe si rrjedhojë sistemi bankar dhe financiar do të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm gjatë periudhës së planifikuar.

Gjithashtu, është vlerësuar si parakusht i planifikimit se Agjencia do të vazhdojë të funksionojë me të njëjtin model të kapitalit njerëzor, çka çmohet si një vlerë institucionale e Agjencisë, si dhe me mbështetjen e partnerëve të saj strategjike. Ndërkohë që do të monitorojmë me kujdes dhe vlerësojmë rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohen subjektet e siguruar, konsiderohet që parakushtet për planifikimin strategjik do të mbeten të pandryshueshme gjatë të gjithë periudhës.



Prioritetet Strategjike, objektivat dhe iniciativat

Prioriteti strategjik 1

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale.

Përmbushja e objektivave të skemës së sigurimit të depozitave është boshti kryesor i punës për planifikimin strategjik të veprimtarisë së Agjencisë. Mirë menaxhimi i të gjitha kapaciteteve, përmirësimi i vazhdueshëm, si dhe transparenca, përgjegjshmëria dhe efektiviteti i strukturave të Agjencisë, konsiderohen thelbësorë për përmbushjen e këtyre objektivave.

Nisur nga performanca e Planit Strategjik 2018-2020, nga rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, por edhe nga proceset e vetëvlerësimit të skemës për përputhshmërinë me parimet bazë të sistemeve efektive të sigurimit të depozitave, Agjencia do të vijojë t'i fokusojë përpjekjet e saj për përmirësimin e kapaciteteve teknologjike dhe financiare, si dhe rritjen e gatishmërisë operacionale në rast ngjarje sigurimi. Objektivat dhe iniciativat strategjike për periudhën 2021-2023, janë mbështetur në rekomandimet e ekspertëve, që i janë ofruar Agjencisë në kuadër të bashkëpunimit me institucionet

vendase dhe të huaja, si dhe në proceset e verifikimit dhe të simulimit të ngjarjeve të sigurimit të kryera në bashkëpunim me subjektet anëtare të skemës.

Objektivi Strategjik: Rritja e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit

- Iniciativa strategjike: Testimi i paraqitjes unike të depozituesve.

Agjencia me qëllim që të rrisë shpejtësinë e ndërhyrjes në rast të një ngjarje sigurimi, gjatë tre viteve në vijim do të ketë në fokus të saj testimin e gatishmërisë së raportimit në kohë dhe saktë nga të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave të skedarëve për simulim/kompensim, në SIRK¹.

Nëpërmjet simulimeve teknike në çdo subjekt anëtar të skemës, do të synohet të rritet saktësia e listë pagesës së depozituesve në rast të një ngjarje sigurimi. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe do të

¹ Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim



intensifikohet puna, në veçanti për verifikimin e përputhjes së të dhënave të raportuara në SIRK me të dhënat në sistemet qendrore të subjekteve lidhur me paraqitjen unike të depozituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Agjencia.

Kontrolli dhe testimi i vazhdueshëm i mbajtjes dhe raportimit të të dhënave të depozituesve në subjektet anëtare si dhe sigurimi në kohë dhe korrekt i paraqitjes unike të depozituesve në një ngjarje sigurimi do të rrisë saktësinë dhe shpejtësinë e përgatitjes së listë pagesës nga Agjencia.

- Iniciativa strategjike: Nxitja e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve përmes Platformës të hartuar për këtë qëllim.

“Platforma strategjike e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar”, e hartuar sipas propozimeve nga të gjitha grupet e interesit, përcakton veprime dhe afate të nevojshme për t’u zbatuar nga të gjithë bankat anëtare të skemës. Agjencia gjatë tre viteve në vijim, do të ndjekë raportimin mbi plotësimin e veprimeve dhe afateve, në përputhje me të. Gjithashtu, për të monitoruar zbatimin e platformës si dhe verifikuar saktësinë e raportimeve të bankave Agjencia do të vijojë të përfshijë në programet

e saj periodike të verifikimeve edhe këtë çështje me rëndësi të madhe për gatishmërinë operacionale të Agjencisë.

Gjatë kryerjes së verifikimeve në çdo subjekt anëtar të skemës si dhe në trajnimet e dedikuara me punonjësit e shërbimit të klientit, Agjencia do të ketë në fokus informimin dhe përgatitjen, lidhur me rëndësinë e saktësisë së hedhjes së të dhënave të depozituesve dhe depozitave, si edhe përditësimin e këtyre të dhënave.

- Iniciativa strategjike: Testimi i bashkëpunimit me Bankat Agjente.

Gjatë tre viteve të ardhshme, Agjencia do të vijojë bashkëpunimin me Bankat Agjente të përzgjedhura në listën paraprake nëpërmjet simulimit të një ngjarje sigurimi, me secilën nga bankat agjente. Agjencia në këto simulime, do të testojë aftësinë e bankave agjente të përzgjedhura për të kryer shpejtë dhe saktë një proces kompensimi, si edhe kuadrin rregullativ të këtij procesi, në mënyrë që t’i përgjigjet më mirë një ngjarjeje të tillë.

Ushtrimet e simulimit do të fillojnë me takime e koordinime reciproke midis Agjencisë dhe bankave agjente, do të vijojnë me trajnime e konsultime të ndryshme në lidhje me procesin e pagesave të kompensimit, si dhe do të kulmohen me kryerjen e pagesave të depozituesve të simuluar, nga ana e tyre.



Në përfundim të ushtrimeve të simulimit synohet të kemi punonjës të bankave agjente të rritur profesionalisht për të kryer procesin e pagesave për kompensim, një bazë rregullative e ligjore më të përshtatshme e të zhdërvjellët për këtë proces, si dhe punonjës të Agjencisë më të kualifikuar në bashkëpunimin me bankat agjente.

Gjithashtu këto simulime do të ndihmojnë në përmirësimin dhe përshtatjen e sistemeve të bankave agjente dhe të Agjencisë për të realizuar me sukses një ngjarje sigurimi.

- Iniciativa strategjike: Sigurimi i kapaciteteve mbështetëse, të nevojshme në rast ngjarje sigurimi.

Gjatë tre viteve të ardhshme Agjencia, me qëllim rritjen e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit, do të fokusohet në sigurimin e listës së operatorëve ofrues të shërbimeve mbështetëse, si dhe rishikimin në mënyrë periodike të saj.

Në vijim, Agjencia e Sigurimit të Depozitave do të bashkëpunojë me partnerë mbështetës për realizimin në kohë dhe me efektivitet të procesit të kompensimit. Subjekte të tilla vlerësohet se do të jenë ndihmues në veprimtarinë e Agjencisë në rast ngjarje sigurimi, me shërbime në fusha të ndryshme si: shërbime dhe mirëmbajtje të platformës elektronike, shërbime auditimi, shërbime kontabiliteti, shërbime ligjore, qendër telefonike (call center) etj.

Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, Agjencia synon të organizojë trajnime me personelin e këtyre subjekteve, me qëllim përgatitjen e tyre në vazhdimësi mbi rolin e tyre specifik në kryerjen e procesit të kompensimit.

- Iniciativa strategjike: Sigurimi i vijueshmërisë së biznesit për veprimtarinë e Agjencisë

Hartimi i Planit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë së Agjencisë ka për qëllim të ofrojë një kuadër administrimi të vendimmarrjes, të nevojshëm në koordinimin e veprimeve reaguese pas një ngjarjeje madhore, që ndërpret aktivitetin e institucionit. Ky plan ka për qëllim të përshkruajë administrimin e vazhdimësisë së aktivitetit të Agjencisë, veprimet që duhen ndërmarrë, burimet që do të përdoren dhe procedurat që duhet të ndiqen para, gjatë dhe pas një ngjarjeje të tillë.

Pavarësisht eksperiencave të mëparshme dhe menaxhimit të mirë gjatë pandemisë, Plani i Vijueshmërisë së biznesit do të konkretizojë funksionet kritike dhe afatet e përmbyshjes së tyre, vendimmarrjen efektive dhe përgatitjen e stafit në mënyrë që veprimtaria e Agjencisë të vijojë pa ndërprerje.



- Iniciativa strategjike: Studim mbi modernizimin e tipareve të skemës.

Vlerësimi për të analizuar metodologjinë e llogaritjes së shumës së mbulimit si dhe rishikimi i listës së përjashtimeve nga mbulimi me sigurim

Vlerësimi i strukturës së primit të sigurimit të depozitave.


Agjencia ka parashikuar që në planin strategjik 2021-2023 në kuadër të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, të vlerësojë hapat e nevojshëm në lidhje me modernizimin e tipareve kryesorë të skemës, duke synuar thjeshtimin e procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave. Për këtë qëllim do të analizohen dhe vlerësohen elementët përbërës të shumës së mbulimit dhe lista e përjashtimeve nga skema e sigurimit të depozitave. Gjithashtu, do të vlerësohet struktura e primit të sigurimit të depozitave në lidhje me formulën e përlllogaritjes së tij. Ky studim do të vlerësojë ndikimin financiar në Agjenci si dhe efektin financiar për subjektet anëtare të skemës. Ky studim do të kryhet bazuar në të dhënat e shumës së depozitave të siguruar, depozitave të sigurueshme, të totalit të depozitave si dhe të dhënat për fondin e kompensimit të Agjencisë.

Objektivi Strategjik: Përmirësimi i kapaciteteve të teknologjisë së informacionit

- Iniciativa strategjike: Automatizimi i administrimit të procesit të kompensimit.

Qëllimi i kësaj iniciative është të përmirësojë SIRK-un si edhe zhvillimin e moduleve të reja të cilat do të automatizojnë procesin e kryerjes së kompensimit. Zhvillimet e reja do të mundësojnë verifikimin e depozituesve në një proces kompensimi si edhe evidentimin e gjurmimit e pagesës së kompensimit. Projekti për zbatimin e kësaj iniciative përfshin gjithashtu zhvillimin dhe implementimin e modulit të përpunimit të ankesave të mundshme të depozituesve në një ngjarje sigurimi, si edhe implementimin e një ambienti raportimi që do të mundësojë një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit informacionit në Agjenci.

Në bashkëpunim me BERZH, Agjencia planifikon të finalizojë termat e referencës për përmirësimin e sistemit SIRK dhe ndërtimin e moduleve të reja për automatizimin e menaxhimit të procesit të kompensimit, në periudhën që përfshin këtë Plan Strategjik.



- Iniciativa strategjike: Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike.

Agjencia, gjatë tre viteve në vijim, do të synojë përmirësimin dhe rritjen e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike. Pjesë e rëndësishme e projekteve që përfshin kjo iniciativë është ndërtimi i një qendre të dytë funksionale për sistemet IT qendrore (Disaster Recovery Site) të Agjencisë, si pjesë e Planit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë së Agjencisë. Kjo qendër e dytë do të sigurojë funksionimin e sistemeve duke mundësuar vazhdimësinë e punës edhe në rast të forcave madhore që pengojnë aktivitetin në qendrën kryesore. Pas ndërtimit të saj do të kryhen testime periodike në mënyrë që të sigurohet vijueshmëria dhe efektiviteti i operacioneve dhe proceseve thelbësore të veprimtarisë së Agjencisë.

Gjithashtu, Agjencia do të përforcojë sigurinë fizike në infrastrukturën teknologjike ekzistuese të saj, duke synuar të minimizojë rreziqet dhe të rrisë aftësitë parandaluese e të ndërhyrjes në kohë, në raste zjarresh dhe situatash të tjera të paparashikuara.

Objektivi Strategjik: Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve financiare

- Iniciativa strategjike: Vlerësimi i gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia.

Agjencia edhe në tre vitet në vijim do të vijojë me testimin e gatishmërisë së saj operacionale, duke u fokusuar edhe në gatishmërisë së fondeve që administron në funksion të një ngjarjeje sigurimi. Këto ushtrime simulimi do të kryhen në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe do të shërbejnë për të vlerësuar nevojat dhe kapacitetin e Agjencisë për kthimin e mjeteve të saj në fonde likuide.

Këto ushtrime do t'i shërbejnë Agjencisë për marrjen e masave për një planifikim më të mirë të investimeve të saj në përputhje me nevojat për fonde likuide, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut të subjekteve anëtare të skemës.

- Adoptimi dhe zbatimi i metodologjisë së stres-testit

Metoda e stres-testit e hartuar së fundmi me asistencën e Bankës Botërore, është një mjet më shumë në dispozicion të Agjencisë, për të përllëgaritur madhësinë e synuar të fondeve të sigurimit të depozitave. Kjo metodologji mund të zbatohet edhe për të vlerësuar ndikimin e një krize sistemike bankare në situatën financiare të anëtarëve të skemës. Rezultatet do të ndikojnë në përbërjen e portofoleve të fondeve të sigurimit të depozitave në mënyrë që Agjencia të jetë sa më e përgatitur në rast të një ngjarje kompensimi. Kjo metodologji merr rëndësi veçanërisht në një periudhë pandemie ku ndikimet në ekonomi janë të



mëdha dhe të gjata, çka mund të ndikojë në gjithë sistemin financiar bankar.

- Iniciativa strategjike: Rritja aftësisë paguese të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi.

Agjencia për të përmbushur objektivat e saj ligjorë në mbrojtje të interesave të depozituesve dhe për të kontribuar në stabilitetin e sistemit bankar e financiar, është në proces negociatash për përfitimin e një linje kredie me BERZH me qëllim rritjen e kapaciteteve financiare të saj në rast të një ngjarje sigurimi.

Linja e kredisë duhet konsideruar si një mekanizëm më shumë, që u shtohet elementeve të sigurisë së skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri në përputhje me standardet ndërkombëtare në disiplinën e sigurimit të depozitave. Ajo rrit nivelin e mbrojtjes së depozituesve, duke përmirësuar nivelin e mbulimit si në nivel depozitash të siguruara, ashtu edhe në nivel institucionesh financiare, që janë pjesë e skemës së sigurimit. Kjo linjë do të forcojë aftësinë financiare të skemës së sigurimit të depozitave si pasojë e pandemisë Covid-19, e cila mund të sjellë goditje financiare me risk të lartë sistemik. Përdorimi i linjës do të siguronte likuiditetin e nevojshëm në rast ngjarje sigurimi brenda një kohe shumë të shkurtër.

Objektivi Strategjik: Modernizimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ me qëllim përputhshmërinë me Direktivën e Bashkimit Evropian dhe Parimet Bazë të IADI-t.

- Iniciativa strategjike: Studimi i ndryshimeve të mundshme të ligjit “Për sigurimin e depozitave”

Një nga elementët e rëndësishëm të planifikimit strategjik është edhe shqyrtimi i përputhshmërisë së kuadrit ligjor dhe rregullativ të juridiksionit vendas me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/49/EU “Për skemat e sigurimit të depozitave”, ose ndryshime të mundshme të saj.

Objektivi kryesor i punës në këtë drejtim, tashmë është përcaktuar, si sigurimi i qartësisë ligjore për mbulimin ose përjashtimin nga sigurimi, shmangia e pengesave për përlllogaritjen e shpejtë dhe të saktë të shumës së kompensimit, si dhe mbështetja me aktet e duhura për koordinimin e vazhdueshëm të Agjencisë me subjektet e skemës, bankat agente dhe institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në rast ngjarje sigurimi. Krahas këtyre elementëve, rekomandimet e dhëna nga ekspertët vendas dhe të huaj, kanë vënë theksin mbi analizimin e mundësive, avantazheve dhe sfidave për vlerësimin e strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij.



Të gjithë këta elementë, kërkojnë ndryshime ligjore dhe nënligjore për sigurimin e depozitave, të cilat prekin të gjithë anëtarët e saj, si Bankën e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit Mbikëqyrës, po kështu edhe bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Me qëllim identifikimin e elementëve që kërkojnë ndryshim, synohet kryerja e analizave të thelluara me subjektet e tregut bankar dhe financiar në vend, për shkak se ato sjellin ndryshime jo vetëm në kostot për skemën e sigurimit të depozitave, por edhe në të dhënat për raportim, si dhe përshtatjen e kapaciteteve operacionale dhe teknologjike për depozitat dhe depozituesit.

Për këtë arsye, gjatë periudhës 2021 – 2023, synohet një bashkëpunim i thelluar me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare në vend, me subjektet anëtare të skemës, si dhe me autoritetet vendase dhe të huaja të ekspertizës, për të identifikuar modalitetet më të përshtatshme për zbatim, në vendin tonë.

- Iniciativa strategjike: Rishikim dhe përmirësim i kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave

Ushtrimet e simulimit dhe proceset e vetëvlerësimit mbi Parimet Themelore të Sistemeve Efektive të Sigurimit të Depozitave të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) konfirmuan konsolidimin e mëtejshëm të skemës së sigurimit të depozitave në vend.

Ndërkohë, gjetjet dhe rekomandimet e hartuara në përfundim të këtyre proceseve, përveç identifikimit për përmirësime teknologjike, operacionale dhe funksionale, kanë vënë theksin edhe mbi përmirësime të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.


Në rast se, analiza e përmirësimeve dhe ndryshimeve, evidenton domosdoshmërinë e rishikimit të dispozitave të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, duhen riparë edhe aktet nënligjore të skemës, të cilat prekin sigurimin e depozitave në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, si dhe të kompensimit të depozitave të siguruara.

Për këtë qëllim, Agjencia do të bashkëveprojë me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare dhe subjektet anëtare të skemës për krijimin e bazës ligjore dhe nënligjore të përshtatshme për zbatimin e përmirësimeve dhe ndryshimeve në skemë.

Objektivi strategjik: Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave.

- Iniciativa strategjike: Përdorimi i mjeteve audiovizive për informimin dhe edukimin e publikut.

Agjencia, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 do të synojë që përmes përdorimit të kanaleve të informimit dhe komunikimit audiovizuale të përçojë tek publiku



informacionin e nevojshëm në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave. Me këtë qëllim qasja e komunikimit me publikun do të konkretizohet përmes videove edukative dhe informuese sa i takon aspekteve të veçanta të aktivitetit të Agjencisë. Kjo qasje synon që informacioni i transmetuar të jetë lehtësisht i perceptueshëm nga të gjithë grup moshat dhe grupet e interesit. Videot do të publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë dhe në llogaritë e mediave sociale të saj.

Gjithashtu, Agjencia do të vijojë të përditësojë materialet informuese dhe edukative, duke pasur në konsideratë ndryshimet e mundshme në kuadrin ligjor e rregullativ të Agjencisë si dhe për tu përshtatur në drejtim të një komunikimi sa më efikas me publikun.

- Iniciativa strategjike: Vlerësime të herëpashershme të nivelit të njohurive të publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë.

Duke vlerësuar që ndërgjegjësimi i publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë është thelbësor jo vetëm për të menaxhuar sa më mirë një ngjarje sigurimi por ndikon edhe në forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, do të angazhohemi që të punojmë dhe të zbatojmë me efektivitet strategjinë e informimit dhe komunikimit me publikun. Ndërgjegjësimi i publikut është një angazhim afatgjatë dhe vlerësimi i efektivitetit të strategjisë për ndërgjegjësimin publik është një detyrë sfiduese. Për të matur


efektivitetin e strategjisë së saj, Agjencia do të kryejë anketime me punonjësit e subjekteve anëtare të skemës si dhe me depozituesit dhe publikun për të vlerësuar nivelin e njohurive të tyre mbi skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë.

Rezultatet e përfuara dhe krahasimi i tyre me të dhënat e studimeve paraardhëse do të na shërbejnë për të orientuar dhe përcaktuar natyrën, shtrirjen dhe shpeshësinë e aktiviteteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit të publikut.

- Iniciativa strategjike: Rritja e efektivitetit të mjeteve të komunikimit me publikun.

Agjencia në periudhën e Planit Strategjik 2021-2023 do të vijojë të përdorë me efektivitet mjetet e saj të komunikimit mbi bazën e parimit të transparencës dhe llogaridhënies, përputhje me Programin e Transparencës të miratuar. Për këtë qëllim Agjencia do të synojë të komunikojë në mënyrë dinamike duke qenë në përputhje me strategjinë e komunikimit të miratuar.

Faqja zyrtare e Agjencisë do të vazhdojë të jetë mjeti kryesor i informimit të publikut për skemën e sigurimit e depozitave dhe Agjencinë duke ofruar informacion të vazhdueshëm dhe të dhëna në interes të publikut. Në vijim, Agjencia synon të rimodelojë faqen e saj zyrtare të internetit me qëllim për ta bërë sa më dinamike dhe thjeshtë në përdorim nga depozituesit dhe publiku i gjerë. Ky rimodelim do të



përfshijë një qasje më të drejtpërdrejtë dhe transparente sa i takon informimit për procesin e kompensimit.

Agjencia është aktive në llogaritë e saj në mediat sociale. Agjencia do të punojë për të identifikuar teknika të reja për të vijuar informimin dhe

edukimin e publikut, sipas tendencave të reja të marketingut dhe përmirësimeve të teknologjisë së informacionit.

Gjithashtu do të vijojë bashkëpunimi me universitetet për të zhvilluar leksione të hapura me studentë, si një nga grupet e synuara të identifikuara në strategjinë e komunikimit.



Prioriteti strategjik 2

Garantimi i vijueshmërisë së partneritetit strategjik.

Bashkëpunimi efektiv me partnerët strategjikë, siç janë institucionet e rrjetit të sigurisë financiare, subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, dhe partnerët ndërkombëtarë do të na ndihmojë që të përmbushim me sukses mandatin ligjor. Ky bashkëpunim përfshin ndërveprimin përmes konsultimeve institucionale dhe transparente me qëllim krijimin e vlerave për të gjithë aktorët e përfshirë. Duke pasur në konsideratë këtë synim do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtësisht me të gjithë partnerët strategjikë të identifikuar për të qenë sa më efikas në realizimin e objektivave dhe iniciativave strategjike të parashikuara në strategjinë e institucionit për vitet 2021-2023.

Objektivi strategjik: Partneriteti strategjik me autoritetet rregullatore.

- Iniciativa strategjike: Pjesëmarrja dhe kontributi në GKSF dhe grupet e punës ad hoc

Agjencia është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), i cili përbëhet nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë kuadër, Agjencia vlerëson se bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend duhet të jetë në fokus të strategjisë së saj

trevjeçare, me qëllim përmbushjen me sukses të mandatit dhe objektivave të saj publike.

Duke marrë në konsideratë rolin thelbësor që institucionet e rrjetit të sigurisë financiare kanë në mbështetjen e një sistemi efikas të sigurimit dhe kompensimit të depozitave, veçanërisht në këtë periudhë të ndikuar nga pandemia e COVID-19, Agjencia do të punojë për të fuqizuar marrëdhëniet institucionale përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit angazhues mbi nismat ligjore, përputhshmërinë e akteve rregullative, pjesëmarrjes dhe kontributit në forumet e përbashkëta apo të ndërsjella si dhe në aktivitetet me synim edukimin financiar të publikut.

Ky bashkëpunim do të funksionojë në kuadër Memorandumit të Bashkëpunimit në fuqi, i cili ka si synim funksionimin e kuadrit rregullativ për administrimin e situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e tregjeve dhe të subjekteve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, përmes zhvillimit të sistemit financiar, parandalimit dhe eventualisht administrimit të këtyre situatave.



- Iniciativa strategjike: Rishikimi i Marrëveshjes tre palëshe ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë

Agjencia konsideron shumë të rëndësishëm forcimin e marrëdhënieve të saj me anëtarët e rrjetit të sigurisë më qëllim përmbushjen e funksioneve të saj institucionale. Në vijim rishikimi i marrëveshjes trepalëshe midis Bankës së Shqipërisë, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është një nga iniciativat prioritare të këtij plani strategjik. Vlen të theksohet që kjo marrëveshje është nënshkruar nga palët në vitin 2012 dhe rishikimi i saj vjen si pasojë e ndryshimeve të kuadrit ligjor në vite. Objekt i marrëveshjes do të jetë bashkëpunimi mes palëve më qëllim plotësimin e fondeve që i nevojiten Agjencisë, për të përmbushur detyrimet e saj ligjore në rast ngjarje sigurimi.

- Iniciativa strategjike: Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave

Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional ndihmon në shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella, në kohë dhe me transparencë si dhe siguron përputhshmërinë e informacionit që përcillet në publik nga burime të ndryshme.

Agjencia do të marrë pjesë në mënyrë aktive në fushatat e edukimit bankar dhe financiar dhe do të vijojë të japë mbështetjen dhe

kontributin e saj në aktivitetet e zhvilluara në Javën e Parasë, organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Objektivi strategjik: Partneriteti strategjik me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave.

- Iniciativa strategjike: Trajnime me anëtarët e skemës, duke synuar thellimin e njohurive të tyre për skemën dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi.

Komunikimi dhe ndërveprimi me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave është prioritet për Agjencinë. Punonjësit e bankave dhe shkk-ve konsiderohen si partnerë shumë të rëndësishëm të Agjencisë në informimin dhe edukimin e depozituesve për skemën e sigurimit të depozitave. Trajnimet dhe takimet me anëtarët e skemës do të zhvillohen me synim thellimin e njohurive për skemën dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi. Për këtë qëllim diskutimi i strategjive dhe bashkërendimi i përpjekjeve të përbashkëta për adresimin e çështjeve dhe problematikave që lidhen me komunikimin me depozituesit dhe publikun, do të jetë në fokus të aktiviteteve trajnuese.



Objektivi strategjik: Partneriteti strategjik me institucionet ndërkombëtare financiare.

- Iniciativa strategjike: Bashkëpunimi me BERZH.

Agjencia është e angazhuar të përmirësojë kapacitetin e saj operacional në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, përfshirë Parimet Bazë për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave dhe standardet e BE-së. Në vijim të marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare, Agjencia do të bashkëpunojë me BERZH për zhvillimin dhe ndryshimet në sistemin ekzistues SIRK të si dhe kryerjen e një studimi mbi mundësinë e adoptimit të sistemit të primit me bazë rreziku. Bashkëpunimi me BERZH në lidhje me SIRK është në vazhden e mbështetjes teknike të mëparshme, e cila u përqendrua në hartimin, zhvillimin e sistemit SIRK të Agjencisë.

Gjithashtu, përmes asistencës teknike të ofruar nga BERZH, Agjencia ka planifikuar të kryejë një studim për të parë mundësinë e aplikimit të llogaritjes së primit mbi bazën e rrezikut të çdo subjekti. Llogaritja e primit bazuar në rrezikun e subjekteve të anëtarëve të skemës është në përputhje me parimet themelore të IADI² “për skemat efektive të sigurimit të depozitave”. Edhe direktiva e Bashkimit Evropian mbi skemat e sigurimit të depozitave nr. 2014/49/EU³, nxit përdorimin e kësaj metode për llogaritje primi.

² <https://www.iadi.org/en/core-principles-and-research/core-principles/>

- Iniciativa strategjike: Bashkëpunimi me Bankën Botërore.


Agjencia në periudhën e Planit Strategjik 2018-2020 ka përfituar nga bashkëpunimi me Bankën Botërore në drejtim të asistencës teknike për realizimin e disa projekteve të rëndësishme si për shembull ai në lidhje me vlerësimin e parametrave financiarë të skemës së sigurimit të depozitave. Duke marrë në konsideratë këtë bashkëpunim të frytshëm Agjencia do të synojë që në Planin Strategjik 2021-2023 të përfshijë ekspertizën e Bankës Botërore në projektet më thelbësore që ka planifikuar. Përfshirja e këtij institucioni ndërkombëtar financiar prestigjioz përmes projekteve të asistencës teknike konsiderohet nga Agjencia si një vlerë e shtuar në procesin strategjik të vendimmarrjes menaxheriale dhe adoptimin e politikave koherente dhe me ndikim në stabilitetin financiar.

Objektivi strategjik: Partneriteti strategjik me institucionet homologe të sigurimit të depozitave

- Iniciativa strategjike: Bashkëpunimi me agjencitë homologe të rajonit në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave.

Agjencia vlerëson se bashkëpunimi rajonal, duke marrë në konsideratë ngjashmëritë e mandateve ligjore dhe institucionale të skemave homologe, duhet të jetë një nga prioritetet e saj në kuadër të partneritetit

³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0049>



strategjik. Në kuadër dhe të pandemisë së Covid-19 dhe ndikimeve që ajo mund të ketë në mbarëvajtjen e sistemeve financiare, bashkëpunimi do të synojë shkëmbimin e eksperiencave me autoritetet homologe, veçanërisht me ato që mund të kenë kaluar një ngjarje sigurimi, rishikimin e mundshëm të protokolleve të bashkëpunimit sipas Marrëveshjeve të Bashkëpunimit në fuqi, dhe kryerjen e ushtrimeve të përbashkëta të simulimit, në varësi të situatave të krijuara nga pandemia Covid-19.



Matrica e Planit Strategjik 2021 2023

| Prioritetet strategjike | Iniciativat strategjike | Projektet | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2021 | 2022 | 2023 |
| Gatishmëria institucionale | | | | |
| Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale | Objektivi: Rritja e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit | | | |
| | Testimi i paraqitjes unike të depozituesve. | <ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës | <ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës | <ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës |
| | Nxitja e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve përmes Platformës së hartuar për këtë qëllim | <ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i Platformës Strategjike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozitave dhe depozituesve në sistemin bankar. • Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. | <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i plotësimit të kërkesave të Platformës Strategjike. • Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. | <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i plotësimit të kërkesave të Platformës Strategjike. • Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. |
| | Testimi i bashkëpunimit me Bankat Agjente. | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnimet dhe konsultime • Simulim BA1 | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnimet dhe konsultime • Simulim BA2 | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnimet dhe konsultime • Simulim BA3 |
| | Sigurimi i kapaciteteve mbështetëse, të nevojshme në rast ngjarje sigurimi. | <ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse | <ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse | <ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse |
| | Sigurimi i vijueshmërisë së biznesit për veprimtarinë e Agjencisë. | <ul style="list-style-type: none"> • Konceptimi dhe hartimi i planit të vijueshmërisë së biznesit (BCP) | <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i BCP-së | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi/përditësimi i BCP-së |
| Studim mbi modernizimin e tipareve të skemës. | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi për të analizuar metodologjinë e llogaritjes së shumës së mbulimit si dhe rishikimi i listës së përjashtimeve • Vlerësimi i strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij | <ul style="list-style-type: none"> • Konsultim me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare • Konsultim me anëtarët e skemës | <ul style="list-style-type: none"> • Propozim për përfshirje në paketën e ndryshimeve të mundshme ligjore | |



| Objektivi: Përmirësimi i kapaciteteve të teknologjisë së informacionit | | | |
|---|--|--|--|
| Automatizimi i administrimit të procesit të kompensimit. | <ul style="list-style-type: none"> • Termat e referencës • Përmirësimi e sistemit SIRK • Ndërtimi i moduleve të reja | <ul style="list-style-type: none"> • Implementimi/zhvillimi • Sistemi live | <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i sistemit • Simulime teknike |
| Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike të Agjencisë. | <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të dhomës së serverave • Krijimi i një qendre të dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site) | <ul style="list-style-type: none"> • Testime periodike | <ul style="list-style-type: none"> • Testime Periodike |
| Objektivi: Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve financiare | | | |
| Vlerësimi i gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia. | <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide | <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide | <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide |
| Adoptimi dhe zbatimi i metodologjisë së stres-testit | <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i politikës për vlerësimin dhe adoptimin e një plani për arritjen e madhësisë së synuar të fondit | <ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve • Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transheve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar | <ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve • Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transheve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar • Rivlerësimi i madhësisë së synuar të fondit të sigurimit të depozitave |
| Rritja aftësisë paguese të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi | <ul style="list-style-type: none"> • Linja e kredisë me BERZH | <ul style="list-style-type: none"> • Raportim | <ul style="list-style-type: none"> • Raportim |
| Objektivi: Modernizimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ me qëllim përputhshmërinë me Direktivën e Bashkimit Evropian dhe Parimet Bazë të IADI | | | |
| Studimi i ndryshimeve të mundshme të ligjit “Për sigurimin e depozitave”. | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim i ndryshimeve të mundshme ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave kryesore të institucionit | <ul style="list-style-type: none"> • Konsultim me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend • Konsultim me anëtarët e skemës | <ul style="list-style-type: none"> • Propozim i ndryshimeve të mundshme ligjore |



| | | | | |
|--|---|---|--|---|
| | Rishikim dhe përmirësim i kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave. | <ul style="list-style-type: none"> Rishikim i akteve nënligjore ekzistuese | <ul style="list-style-type: none"> Konsultim me Autoritetin Mbikëqyrës Konsultim me anëtarët e skemës | <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i ndryshimeve të mundshme të akteve nënligjore në vijim të ndryshimit të ligjit "Për sigurimin e depozitave" |
| Objektivi: Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave | | | | |
| | Përdorimi i mjeteve audio-vizive për informimin dhe edukimin e publikut. | <ul style="list-style-type: none"> Komunikim audio-vizual Materiale informative | <ul style="list-style-type: none"> Komunikim audio-vizual Materiale informative | <ul style="list-style-type: none"> Komunikim audio-vizual Materiale informative |
| | Vlerësime të herëpashershme të nivelit të njohurive të publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë. | <ul style="list-style-type: none"> Anketim për matjen e nivelit të njohurive të publikut | <ul style="list-style-type: none"> Analiza e të dhënave të anketimit | <ul style="list-style-type: none"> Anketim për matjen e nivelit të njohurive të publikut |
| | Rritja e efektivitetit të mjeteve të komunikimit me publikun | <ul style="list-style-type: none"> Komunikim online me publikun | <ul style="list-style-type: none"> Ri konceptim dhe rindërtim i faqes ëeb Komunikim online me publikun | <ul style="list-style-type: none"> Komunikim online me publikun |
| Partneriteti Strategjik | | | | |
| | Objektivi: Partneriteti strategjik me autoritetet rregullatore | | | |
| Garantimi i vijueshmërisë së partneritetit strategjik | Pjesëmarrja dhe kontributi në GKSF dhe grupet e punës <i>ad hoc</i> . | <ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF | <ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF | <ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF |
| | Rishikimi i marrëveshjes trepalëshe ndërmjet BSH-ASD-MFE. | <ul style="list-style-type: none"> Diskutimi i draft-marrëveshjes | <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Marrëveshjes | |
| | Bashkëpunim me BSH dhe SHSHB. | <ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar | <ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar | <ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar |



| Objektivi: Partneriteti strategjik me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave | | | |
|--|--|---|--|
| Trajnime me anëtarët e skemës, duke synuar thellimin e njohurive dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi. | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnime • Përditësim i materialit trajnues | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnime • Përditësim i materialit trajnues | <ul style="list-style-type: none"> • Trajnime • Përditësim i materialit trajnues |
| Objektivi: Partneriteti strategjik me institucionet ndërkombëtare financiare | | | |
| Bashkëpunimi me BERZH. | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimi • Studim mbi mundësinë e adoptimit të sistemit të primit me bazë rreziku | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimi | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimi |
| Bashkëpunimi me Bankën Botërore | <ul style="list-style-type: none"> • Asistencë teknike | <ul style="list-style-type: none"> • Asistencë teknike | <ul style="list-style-type: none"> • Asistencë teknike |
| Objektivi: Partneriteti strategjik me institucionet homologe rajonale të sigurimit të depozitave | | | |
| Bashkëpunim me agjencitë homologe të rajonit në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave. | <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI | <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI • Komunikim me homologët • Rishikim i MB në fuqi | <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI • Komunikim me homologët për të vlerësuar mundësitë e simulimeve të përbashkëta. |



Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike

Në përmbushjen e prioriteteve të një Plani Strategjik, element që duhet marrë në konsideratë është edhe administrimi i rreziqeve që mund të shfaqen gjatë zbatimit të këtij plani. Administrimi i rreziqeve nënkupton identifikimin, vlerësimin, adresimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre, si dhe raportimin në strukturat përgjegjëse. Përveç rreziqeve të identifikuara dhe të administruara nga Agjencia në vijueshmëri si rreziqet financiare, rreziqet operationale dhe rreziqet në kompensim, në këtë plan trevjeçar marrin rëndësi dhe rreziqet e jashtme, konkretisht si pasojë e pandemisë, efektet e së cilës shtrihen në një kohë relativisht të gjatë dhe ndikimet mund të jenë sistemike. Megjithëse sistemi bankar është me tregues financiarë të kënaqshëm dhe ka rritur nivelin e rezervave për të përballuar një përkeqësim të situatës në krahasim me vitin 2020, efektet ekonomike të pandemisë sërisht duhet të ngrenë vigjilencën në Agjenci. Pikërisht për këtë arsye, në këtë plan strategjik janë

përfshirë projekte si: *“Rritja e aftësisë paguese të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi përmes konkretizimit të Linjës së kredisë me BERZH-in”, “Konceptimi dhe hartimi i një plani vijueshmërie biznesi (BCP) për veprimtarinë e Agjencisë”* apo *“Hartimi i politikës për vlerësimin dhe adoptimin e një plani për arritjen e madhësisë së synuar të fondit”*. Duke qenë se efektet e pandemisë kanë filluar që në vitin e kaluar, është menduar që këto projekte të realizohen që në fillim të periudhës trevjeçare të planit strategjik.

Pavarësisht sa më lart Agjencia, në këtë plan strategjik, vijon të ketë në vëmendje rreziqet e tjera si rreziqet financiare ku përfshihen rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit. Për të minimizuar rrezikun e likuiditetit, gjatë këtij plan strategjik, Agjencia do të rinovojë marrëveshjen trepalëshe me anëtarët e tjerë të rrjetit të sigurisë financiare si dhe do të nënshkruajë një marrëveshje për një linjë kredie me BERZH-in.



Plani Financiar 2021 - 2023

Plani financiar i Agjencisë është bazuar në analizën historike të treguesve të saj financiarë të raportuara sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe në politikën e investimit të mjeteve financiare në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë.

Këto parime do të zbatohen në vijimësi për planifikimin financiar në kuadër të kësaj strategjie.


Bazuar në rezultatet e periudhave të përfshira në planin e mëparshëm strategjik si edhe në projektet strategjike të propozuara nga strukturat e Agjencisë, në tre vitet e ardhshme parashikohet që:

- Të ardhurat nga primi i sigurimit të rriten çdo vit në masën 1%.
- Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë të rriten çdo vit në masën 1%.
- Shpenzimet korrente të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 3%.
- Shpenzimet kapitale të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 3%.

Tabela më poshtë jep planin financiar të Agjencisë të miratuar për vitin 2021, burimet financiare që duhen për të siguruar vijimësinë e planit strategjik gjatë këtij viti si edhe parashikimet financiare për vitet 2022 dhe 2023.



| | 2021 | 2022 | 2023 |
|---|--------------------------|----------------------|----------------------|
| Të Ardhurat | 4,844,487,063 | 4,892,931,933 | 4,941,861,253 |
| Të ardhura nga Primet e sigurimit | 3,626,003,807 | 3,662,263,845 | 3,698,886,483 |
| Të ardhura nga kontributet fillestare | | - | - |
| Të ardhura nga interesat | 1,218,483,256 | 1,230,668,089 | 1,242,974,769 |
| Të ardhura të tjera operative | | - | - |
| Shpenzime | (213,400,715.427) | (189,605,600) | (166,024,380) |
| Shpenzime financiare | (7,261,976) | (10,990,948) | (14,831,789) |
| Shpenzime operative | (113,363,739) | (116,764,651) | (120,267,591) |
| Shpenzime financiare për linjën e kredisë | (92,775,000) | (61,850,000) | (30,925,000) |
| FITIM/HUMBJE NGA AKTIVITETI | 4,631,086,347 | 4,703,326,334 | 4,775,836,872 |



Shënime shpjeguese:

- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga primet është bazuar në trendin e rritjes së moderuar të depozitave të siguruara në subjektet anëtare të skemës së sigurimit në periudhat e mëparshme.
- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga investimet e mjeteve financiare është bazuar në metodën historike dhe të variancës si

dhe rezultatet nga devijimi standard i të dhënave të realizimit të buxhetit në raport me planin në vitet e kaluara.

- Planifikimi për shpenzimet operative konsiston në rritjen e shpenzimeve operacionale dhe shpenzimeve kapitale për vijueshmërinë e aktivitetit të Agjencisë në përputhje me objektivat strategjike të këtij plani.
- Planifikimi për shpenzime financiare është në përputhje me aktivitetin e Agjencisë në periudhën e këtij plani afatmesëm.
- Plani financiar përfshin pagesën e tarifave në lidhje me përfitimin e Linjës së Kredisë nga BERZH.



Performanca e Planit Strategjik 2018-2020

Agjencia vlerëson se Plani Strategjik 2018-2020 ka një realizim të kënaqshëm. Plani Strategjik 2018-2020 ka realizuar objektivat dhe iniciativat e planifikuara sipas parashikimeve, ndërkohë që janë

identifikuar iniciativat e rikonsideruara, të cilat janë përfshirë në Planin Strategjik 2021-2023. Në tabelën e mëposhtme prezantohet ecuria e projekteve të parashikuara në kuadër të Planit Strategjik 2018-2020.

Legjenda

R Realizuar

RI Rikonsiderim i iniciativës

| Prioriteti 1: Efikasiteti Skemës së Sigurimit të Depozitave | | | |
|---|--|----------|--|
| Objektivi | Iniciativat Kryesore | Statusi | Komente |
| Gatishmëria operacionale për kompensim | Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike lidhur me sistemin e raportimit. | R | Përmes projekteve specifike është përmirësuar gatishmëria e infrastrukturës IT të institucionit |
| | Përmirësimi i cilësisë së të dhënave për depozituesit dhe depozitat e siguruara. | R | Agjencia hartoi dhe finalizoi Platformën për përmirësimin e cilësisë së të dhënave për depozituesit dhe depozitat e siguruara, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe konsultim me Shoqatën Shqiptare të Bankave. |



| | | | |
|--|--|---|---|
| | Zhvillimi i sistemit IT për modulin e kryerjes së procesit të kompensimit. | R | Është realizuar rritja/përmirësimi i kapacitetit/shpejtësisë së ngarkimit/shkarkimit të të dhënave në SIRK. Gjithashtu, janë miratuar dhe aktet përkatëse nënligjore të nevojshme për automatizimin e kryerjes së procesit të kompensimit. |
| | | R | Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Korporata Koreane e Sigurimit të Depozitave përfunduan projektin për krijimin e masterplanit të një sistemi të integruar të sigurimit të depozitave. |
| | Zhvillimi i planeve të punës për bashkëpunimin me Bankat Agjente në rast të një ngjarje sigurimi. | R | Gjatë këtij plani strategjik Agjencia kreu ushtrime simulimi me të tre bankat agjente të përzgjedhura |
| | Identifikimi dhe përzgjedhja paraprake e partnerëve mbështetës për procesin e kompensimit. | R | Agjencia përfundoi procedurat për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake, për periudhën 2021-2023 dhe subjekte të tjera mbështetëse. |
| | Përcaktimi i metodologjisë për përlogaritjen paraprake të kostos së procesit të kompensimit në rast të një ngjarje sigurimi. | R | Aktualisht është përgatitur buxheti për një ngjarje kompensimi dhe metodologjia për përlogaritjen paraprake të kostos së një procesi kompensimi. |



| | | | |
|---|--|----|--|
| | Rishikim dhe përmirësim i kuadrit ligjor dhe rregullator të nevojshëm për kryerjen e procesit të kompensimit. | R | <p>Në zbatim të kësaj iniciative, janë miratuar dhe rishikuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. 2. Rregullorja për Trajtimin e Ankesave në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave në Rast Ngjarjeje Sigurimi. 3. Projekt buxheti në rast ngjarje kompensimi, si pjesë e Planit të veprimit për procesin e kompensimit. 4. Manuali për procedurën e brendshme për përgatitjen e listë-pagesës. 5. Rregullorja “Mbi përdorimin e aseteve të teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e informacionit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”. 6. Manuali i Operacioneve Monetare. 7. Manuali i verifikimit. 8. Plani i veprimit për procesin e kompensimit. 9. Rregullorja e për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit në ASD. |
| Kontributi për një regjim efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme | Ngritja e infrastrukturës së duhur në Agjenci për përgatitjen dhe vlerësimin e opinionëve për planet e NJ. | R | Agjencia tashmë ka përcaktuar strukturat përgjegjëse dhe ka formalizuar detyrat funksionale të tyre për këtë qëllim. |
| | Hartimi i metodës për vlerësimin paraprak të ekspozimit të fondit të kompensimit në rast të pjesëmarrjes në planin e NJ. | RI | Kjo iniciativë u rikonsiderua në bashkëpunim me ANJ. |



| | | | |
|--|--|----|---|
| <p>Administrimi i shëndetshëm i fondeve të kompensimit të depozitave dhe NJ, sigurimi i burimeve të përshtatshme për financimin e tyre.</p> | <p>Ruajtja e treguesve të performancës financiare përkundrejt buxhetit të miratuar. (varianca 5%).</p> | R | <p>Agjencia ka monitoruar në vazhdimësi treguesit financiarë të Agjencisë për të siguruar ruajtjen e variancës së pranuar sipas Planit Strategjik.</p> |
| | <p>Vlerësimi në vazhdimësi i nivelit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe plotësimit në kohë të nevojave për likuiditet në rast të një ngjarje kompensimi nëpërmjet një sistemi paralajmërimi të hershëm.</p> | R | <p>Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Bankën Botërore.</p> |
| | <p>Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të kostos të administrimit të fondeve të kompensimit të depozitave dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.</p> | R | <p>Në vijim të diskutimeve me ANJ është miratuar në muajin Janar 2019 metodologjia për vlerësimin e kostove të administrimit të FNJ, e cila është vënë në zbatim për llogaritjen e kostove të administrimit për vitin 2018.</p> |
| | <p>Përmirësimi i metodës së administrimit të rreziqeve lidhur me investimet dhe portofolin e letrave me vlerë të investuara.</p> | RI | <p>Në dakordësi dhe bashkëpunim me Auditin e Brendshëm dhe të Jashtëm u vlerësua se mekanizmat e kontrollit të brendshëm për monitorimin e aktivitetit investues janë të mjaftueshme.</p> |
| <p>Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut ndaj skemës së sigurimit të depozitave</p> | <p>Të vijojë të nxisë edukimin financiar të publikut në vend nëpërmjet pjesëmarrjes së Agjencisë në programet e edukimit financiar ndërinstitucional.</p> | R | <p>Agjencia ka marrë pjesë në aktivitetet e zhvilluara gjatë Javës Globale të Parasë në bashkëpunim me ShShB dhe BSH, si dhe në aktivitete të tjera ndërinstitucionale.</p> |
| | <p>Të vijojë rritjen e komunikimit me grupet e targetuara për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për</p> | R | <p>Agjencia ka vijuar ndërgjegjësimin e grupeve të targetuara përmes përdorimit të mjeteve dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit.</p> |



| | | | |
|--|---|----|---|
| | Agjencinë dhe rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje sigurimi. | | |
| | Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në informimin e publikut dhe grupet e tjera të interesit lidhur me rolin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Agjencisë për sigurimin e depozitave dhe rolin e saj, veçanërisht në një ngjarje sigurimi. | R | Në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit” dhe “Programin e transparencës” janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në Agjenci. |
| | Të vlerësojë në vazhdimësi efektivitetin e strategjisë së komunikimit. | RI | Rikonsiderim i iniciativës. Anketimi parashikohet të realizohet në vitin 2021. |
| Vlerësim i efektivitetit të skemës së sigurimit të depozitave | Vlerësimi i përshtatshmërisë së treguesve financiarë të skemës së sigurimit të depozitave sipas standardeve përkatëse të IADI/EFDI. | R | Ky projekt u realizua në bashkëpunim me Bankën Botërore. |
| | Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës me Parimet Themelore për një Sistem Efektiv të Sigurimit të Depozitave. | R | Projekti u realizua në bashkëpunim me FSVC. Procesi i vlerësimit përcaktoi se Agjencia është në përputhje ose gjerësisht në përputhje me 15 nga Parimet Themelore dhe materialisht në mospërputhje me një Parim Themelor. |




Prioriteti 2: Menaxhimi i Kapitalit Njerëzor

| Objektivi | Iniciativat Kryesore | Statusi | Komente |
|---|---|---------|---|
| Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin profesional të punonjësve në përputhje me vizionin dhe misionin e Agjencisë. | Hartimi i dokumentit të strategjisë së zhvillimit të burimeve njerëzore. | R | Miraturar me vendim të Këshillit Drejtues. |
| | Identifikimi i nevojave për zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve. | R | Ky proces zbatohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore. |
| | Hartimi i programeve të trajnimit dhe aplikimi i metodave të edukimit që sigurojnë përfitim sa më efektiv të njohurive të reja nga punonjësit si edhe transferimin e tyre midis punonjësve. | R | Ky proces zbatohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore. |
| Motivimi dhe ruajtja e personelit ekzistues si dhe tërheqja e talenteve të reja. | Promovimi i punonjësve bazuar në sistemin e performancës. | R | Sistemi i vlerësimit të performancës vijon të aplikohet në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli Drejtues. |
| | Tërheqja e talenteve të reja nëpërmjet nxitjes së sistemit të praktikave studentore në ASD dhe bashkëpunimit me universitete vendase. | R | Agjencia angazhoi studentë ekselence, të cilët kryen internship pranë ambienteve të saj. |



Prioriteti 3: Zhvillim Strategjik i Partneritetit

| Objektivi | Iniciativat Kryesore | Statusi | Komente |
|---|---|---------|--|
| Përforcimi i marrëdhënieve me institucionet e GKSF. | Forcimi i bashkëpunimit dhe rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me BSH përfshirë zbatimin e detyrimeve ligjore të NJ. | R | Sipas planifikimit Marrëveshja e rishikuar e Bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë u nënshkrua në muajin Dhjetor 2019. |
| | | RI | Kjo iniciativë do të operacionalizohet dhe kalojë për implementim në Planin Strategjik 2021-2023. |
| Zhvillimi i marrëdhënieve me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe institucione të tjerë të sektorit. | Intensifikimi i marrëdhënieve me subjektet e skemës. | R | U kryen takime me të gjitha bankat dhe shkk-të anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në lidhje mirëmbajtjen e të dhënave të depozitave dhe depozituesve. Janë mbajtur marrëdhënie të ngushta trajnimi, këshillimi dhe informimi me të gjithë anëtarët e skemës. |
| | Nënshkrimi i MOU me SHSHB | R | Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe ASD u nënshkrua në muajin dhjetor 2018. |




| | | | |
|--|---|----------|---|
| <p>Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare në të cilat ASD aderon.</p> | <p>Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe.</p> | <p>R</p> | <p>Në funksion të këtij objektivi u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Ndërbankar të Mbrojtjes së Depozitave (Fondo Interbancario di Tutela dei Depositi - FITD) të Republikës së Italisë dhe me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Turqisë.</p> |
| | <p>Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të anëtarësisë në EFDI dhe IADI.</p> | <p>R</p> | <p>Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të anëtarësisë në EFDI dhe IADI gjatë periudhës së raportuar ka vijuar normalisht, duke kulmuar me organizmin e takimit të 40^{të} të Komitetit Rajonal të Evropës (Europe Regional Committee) të IADI-t si dhe seminarin teknik me temë “Planet e Kontigjencës dhe Menaxhimi i Krizave/Rastet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”.</p> |



Performanca financiare 2018-2020

| | Në mln lekë | Buxheti 2018 Parashikim | Buxheti 2018 Realizim | Ndryshimi në % | Buxheti 2019 Parashikim | Buxheti 2019 Realizim | Ndryshimi në % | Buxheti 2020 Parashikim | Buxheti 2020 Realizim* | Ndryshimi në % |
|--------------------------------------|-------------|-------------------------------|-----------------------------|-------------------|-------------------------------|-----------------------------|-------------------|-------------------------------|------------------------------|-------------------|
| Të Ardhurat | | 4,086 | 4,288 | 4.9% | 4,135 | 4,475 | 8.2% | 4,186 | 4,715 | 12.6% |
| 1 Nga Primet | | 3,221 | 3,276 | 1.7% | 3,253 | 3,393 | 4.3% | 3,285 | 3,590 | 9.3% |
| a) Fondi Banka | | 3,210 | 3,273 | 2.0% | 3,242 | 3,376 | 4.1% | 3,275 | 3,572 | 9.1% |
| b) Fondi SHKK | | 11 | 13 | 27.6% | 11 | 16 | 55.5% | 11 | 19 | 73.2% |
| 2 Nga investimi i mjeteve financiare | | 865 | 1,001 | 15.7% | 883 | 1,082 | 22.6% | 900 | 1,143 | 27.0% |
| a) Fondi Banka | | 864 | 999 | 15.7% | 881 | 1,081 | 22.6% | 899 | 1,141 | 26.9% |
| b) Fondi SHKK | | 2 | 2 | | 2 | 2 | | 2 | 2 | |
| Totali Shpenzimeve | | 192 | 156 | -18.9% | 198 | 139 | -29.7% | 218 | 144 | -33.6% |
| Shpenzimet Korrente | | 180 | 146 | -18.8% | 189 | 137 | -27.4% | 199 | 140 | -29.5% |
| Operative | | 82 | 57 | -29.8% | 86 | 51 | -40.0% | 90 | 34 | -61.8% |
| Personeli | | 90 | 82 | -9.5% | 95 | 82 | -13.8% | 100 | 95 | -4.2% |
| Të tjera | | 8 | 7 | -10.9% | 9 | 4 | -50.1% | 9 | 10 | 12.3% |
| Shpenzimet Kapitale | | 12 | 10 | -21.2% | 9 | 1 | -82.6% | 19 | 5 | -76.3% |
| Aktive Afatgjata Materiale | | 12 | 10 | -21.2% | 9 | 1 | -82.6% | 2 | 5 | 125.5% |
| Aktive Afatgjata Jo Materiale | | - | - | | - | - | | 17 | - | |
| Total shpenzime vs Total te ardhura | | 4.71% | 3.65% | | 4.78% | 3.10% | | 5.20% | 3.06% | |

*Të dhënat për vitin 2020 referuar realizimit të pritshëm




Përgjatë viteve 2018-2021 Agjencia në vijueshmërinë e aktivitetit të saj ka patur në vëmendje të vazhdueshme realizimin e planit financiar të miratuar për këtë Plan Strategjik.

Tabela e mësipërme paraqet raportin e realizimit e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt parashikimit për tre vitet financiare 2018 – 2020.

Siç duket qartë edhe nga tabela të ardhurat nga primet dhe investimi i mjeteve financiare gjatë tre viteve kanë patur një trend rritës në realizimin e tyre kundrejt parashikimit.

Në zhvillimin e aktivitetit të saj, bazuar në objektivat e parashikuara në Planin Strategjik 2018-2020, Agjencia ka treguar kujdes duke menaxhuar me eficiencë dhe efikasitet shpenzimet dhe realizuar iniciativat e saj bazuar në parimin kosto-përfitim.

Referuar të dhënave raporti Total shpenzime kundrejt Total të ardhura është luhatur nga 3.06%-3.65% duke respektuar iniciativën e mbajtjes së peshës specifike të totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave, në nivelin 3-6%.



Përmbyllje

Iniciativat e Planit Strategjik 2021-2023 do të përcillen në të gjithë strukturat e Agjencisë me qëllim zhvillimin dhe realizimin e tyre me sukses. Ecuria e iniciativave të Planit Strategjik 2021-2023 do të monitorohet nga Komiteti i Strategjisë dhe raportohet periodikisht në Këshillin Drejtues të Agjencisë.

Agjencia do të vijojë të jetë vigjilente që, në rast të ndryshimeve të mundshme në mjedisin operacional të Agjencisë apo të anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave, të reagojë në kohë për të rishikuar iniciativat e saj strategjike si dhe të rifokusojë burimet e saj duke ruajtur vazhdimësinë e funksioneve të saj kyçe.